



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**FTESË PËR PJESËMARRJE ONLINE NË KURSIN II-të TË TRAJNIMIT  
“ENTREPRENEURSHIP SKILLS IN SCHOOLS DURING NEW NORMAL TIMES”,  
IZRAEL**

Ministria e Punëve të Jashtme të Izraelit njofton se Qendra e Trajnimeve të Agjencisë së Bashkëpunimit për zhvillimin Ndërkombëtar të Izraelit (MASHAV) organizon kursin e II-të të trajnimit në fushën e arsimit, me temë: “Entrepreneurship Skills in Schools during New Normal Times”, i cili do të zhvillohet *online* në datat 22 tetor – 19 nëntor 2020.

Kursi i ofruar nga Qendra Ndërkombëtare e Edukimit “A. Ofri MASHAV” paraqet një program të integruar e të përqëndruar në qasjet inovative pedagogjike në arsim, ide të reja praktike, rritje profesionale, praktikë dhe ekesperiencë, ekspozim ndaj mjeteve metodologjike që po përdoren në kuadër të përvojave të fituara gjatë procesit mësimor.

Pjesëmarrësit në këtë kurs duhet të jenë profesionistë të arsimit, edukatorë dhe mësues. Çështjet që do të trajtohen gjatë këtij kursi janë: të menduarit kreativ, zhvillimi i aftësive sociale dhe teknikave në grup, motivimi në procesin e të mësuarit, etj.

Formulari i plotësuar i aplikimit duhet të dërgohet pranë Ambasadës së Izraelit në Tiranë, jo më vonë se **data 08.10.2020**, që është edhe afati i fundit për aplikim.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe kushteve që duhet të plotësojë kandidati, ju lutemi referojuni adresave të mëposhtme në web:

<http://mashav.mfa.gov.il/MFA/mashav/Courses/Pages/default.aspx>

<http://embassies.gov.il/pretoria/Mashav/calendar-of-Mashav/SiteAssets/Pages/Neë-pedagogies-in-the-21st-century---for-Higher-Education-Teachers/Neë%20pedagogies%20in%20the%2021st%20century%20-%20for%20Higher%20Education%20Teachers.pdf>

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**